



PROCESVERBAL VI/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VI (gjashtë) për vitin 2024 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 19.06.2024
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Kryetari i Komunës z. Bali Muharremaj
Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Suharekës për vitin 2025-2027;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e vlerës së bonus banimit;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Fshatin Rekreativ-Turistik në Delloc”;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës 01-Nr-181-30362;**

Dardan Berisha - nuk e di a ju ka ardhë juve një email apo vetëm mua,një rikërkesë nga FC “Suhareka”

Kryesuesi - po m'ka ardhë kërkesa dhe përgjigjen që ia kam kthyer, e keni edhe ju.

Liridon Fandaj - te përgjigja që iu ka kthyer,ju keni thënë që është kompetencë e ekzekutivit.Realisht kur është votu për me u dhënë,është dhënë prej Asamblesë.

Avni Bytqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që prona e stadiumit është dhënë afatshkurtër dhe Kuvendi e jep vetëm pëlqimin për të zhvilluar procedurat e ankandit publik. Më tutje përgjegjësia është e komisionit dhe e Kryetarit të komunës se si e japin dhe si e bën mbikqyrjen me kontratën e paraparë se kush është organ kompetent për të mbikqyr kontratën. Në këtë rast Kuvendi i komunës nuk është përgjegjës për mbikqyrjen dhe nuk ka mandat dhe kompetencë me inicu procedurën për të dhënë në shfrytëzim pronën publike.

Urim Suka- kuvendi e jep pëlqimin për me u ndjek procedurat dhe pasi të ndiqen procedurat duhet me marrë vendimin.A e merr edhe Kuvendi vendimin?

Avni Bytqi - jo,afatshkurtër nuk e merr.Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Suharekës për vitin 2025-2027;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - kur ka qenë çështja e buxhetit kemi dhënë vërejtjet tona por në disa korniza më herët vërejtjet kanë qenë më shumë te emrat konkret sepse kemi pas rrugë konkrete me emra.Ky material që na ka ardhë shifet që nuk është i përgatitur fare.Vitin e kaluar kanë qenë me emra konkret disa vendbanime të paktën dhe tash as këto nuk janë.Vitin e kaluar ne paraprakisht jemi ftu si shefa të grupeve para se me na ardhë ky material ku kemi diskutu dhe e kemi pas një mundësi me i dhënë vërejtjet dhe sugjerimet tona dhe kjo këtë vit nuk ka ndodh.Ju keni mbajtur dëgjime publike dhe i keni marrë shqetësimet e qytetarëve

dhe nuk figurojnë këtu. Ju i keni dërgu shkresë Kryesive të fshatarave me bë një listë se çka me u investu për periudhën e ardhshme. Kryetarët e fshatrave të paktën në Bllacë që e di, e kanë sjell listën dhe asnjë propozim i tyre nuk figuron aty dhe kjo është jo serioze. Për mua është e papranueshme dhe unë kisha propozu të përmirësohet dhe pastaj të dërgohet në Asamble sepse është dokumenti kryesor që ne duhet ta miratojmë. Prej që jam në Asamble në planifikim është shkolla “7 Marsi” dhe Komuna dhe realizim nuk ka asgjë.

Kryesuesi - sa i përket shkollës “7 Marsi” dhe Komunës, këto futen me qëllimin që ta ketë një kuotë buxhetore dhe me u fut më lehtë me bashkëfinancim dhe për këtë qëllim barten sepse ne e dimë që shkolla nuk ndërtohet me 100.000€ .

Urim Suka - arsytimi shumë i bazuar por jo me këtë që e keni shkruar këtu. Është jo serioze dhe unë ju lus që mos ta votoni në këtë formë.

Liridon Fandaj - unë kam marrë pjesë në dëgjime publike në fshatin Peqan edhe vitin e kaluar dhe këtë vit. Ato që janë propozu nga qytetarët vitin e kaluar, asnjëra prej tyre nuk është fut në buxhet, vet fakti tregon edhe për mos pjesëmarrje. Nëse nuk merren shqetësimet dhe kërkesat e qytetarëve atëherë është e kotë. Te secili fshat e keni bë vetëm rrugë lokale.

Armend Krasniqi - nuk është mirë me bo propagandë.

Liridon Fandaj - nuk e di cila është propaganda por unë e di që dëgjimet publike nëse mbahen me qytetarë, duhet mu marrë qytetarët dhe jo kryetari i fshatit.

Armend Krasniqi - rrugët që janë propozu janë kryer. Ujin nuk po e lidhni.

Liridon Fandaj - ky buxhet u desht paraprakisht para dëgjimeve publike me na ardhë në email.

Kryesuesi - sa i përket kornizës është e vërtetë që nuk e kemi përcjell por ka qenë në faqe të komunës.

Armend Krasniqi - Liridon, a ka mundësi dy projekte që i kanë propozu qytetarët dhe që s’janë realizu ti përmendësh këtu.

Liridon Fandaj - po, kanë kërku me rregullu kishën.

Armend Krasniqi - nuk është e vërtetë.

Liridon Fandaj - po, mund ta jap emrin dhe mbiemrin se kush e ka propozu. Te projekti i ujit, 80.000€ i keni dhënë dhe sot nuk kanë ujë.

Armend Krasniqi - në kuadër të planifikimit për fshatin Peqan, mjetet të cilat janë dedikuar asnjë mjet nuk ka mbet i pa shpenzuar.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

4 për, 3 kundër, Miratohet Pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e vlerës së bonus banimit;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Nënkryetarja - dihet që bonus banimi u ndahet nënave vetushqyese. Te neni 1 thuhet 50% e shumës së qerasë minimale, do të thotë nuk është e caktuar sa është qeraja minimale. Ndoshta është mirë me caktu një qera minimale, çoftë 250€ ose 200€.

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime dhe thotë që çështja e caktimit të vlerës minimale është e përcaktuar me ligj dhe ne nuk mund të ndërhyjmë. Të gjithë ata të cilët ofrojnë kontrata me qera duhet të ofrohet kontrata e nënshkruar nga noteri. Përgjegjësia e Kuvendit është me i përcaktu vlerat minimale që është 50% dhe përgjegjësia tjetër i bie komisionit dhe i bie vet qiradhënësit që e ka përcaktu me kontratë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - sa është qeraja minimale e përcaktuar me ligj?

Avni Bytyqi - vlera e bonos banimit është 50% e vlerës minimale të vlerës së qerasë. Qiraja përcaktohet te noteri. Çmimi në treg është i lirë dhe nuk guxon me kufizu.

Sanie Kuçi Rexhepaj - më vje mirë që ka ardhë një projekt-vendim i tillë për shkak se ka qenë edhe propozim i grupit të grave para dy viteve që numri i familjeve për mbështetje për bonos banim të rritet.

Sa kam informacion çështja e bonus banimit rrjedh nga programi i veçant i banimit ku ai program ka qenë nga viti 2019 deri në vitin 2021 në fuqi dhe tash nuk është më në fuqi. A ka peshë ligjore si projekt -

vendim që po e marrim pa pas komuna program të veçantë të banimit ?A kërkohet me rifresku atë program dhe me fuqizu prap në mënyrë që me marrë një vendim të tillë?

Avni Bytyqi - bazën ligjore ky projekt-vendim e ka te ligji për financimin e programeve të veçanta dhe në kuadër të programit për banimin 3 vjeçar duhet të futet kjo çështje dhe ka qenë e përfshirë mirëpo nuk e ndalon në aspektin ligjor pse ne po e marrim një vendim.Zyrtari ligjor tutje jep sqarime dhe thotë që programi për banimet e veçanta duhet të ripërtrihet.

Sanie Kuçi Rexhepaj - me program në atë kohë kanë qenë 20 familje përfituese çdo vit dhe tash jemi 5 vite e mbas dhe prap numri është 12 .Atëherë si grup është propozu që 15 me qenë përfitues të rregullt dhe 5 me qenë përfitues atëhok që komuna ose komisioni i arsyeton nëse ka ndonjë rast.Pse s'po marrin iniciativë që brenda këtij neni komisioni me pas të drejtë ti zgjedh edhe 5 përfitues për rastet atëhoke?

Avni Bytyqi - kur e kemi bërë programin e veçant për banim ne e kemi planifiku që kur të bëhet objekti komuna gjithmonë 5 banesa me i pas në dispozicion për rastet atëhoke por një gjë e tillë nuk ka ndodh.Te bonus banimi thotë që çdo familje në moment që e rregullon çështjen e banimit është e obliguar me liru banesën dhe komuna e ka të drejtën me ia dhënë dikujt tjetër por nuk ndodh.

Sanie Kuçi Rexhepaj - unë po them që ti ketë 5 opsione që nëse na shfaqen rastësisht dhe që kanë nevojë për banim,p.sh rastet që nuk kanë strehim ose rastet emergjente me i pas komisioni si opcion pa lejen e kuvendit.

Avni Bytyqi - udhëzimi e thotë që duhet të përcaktohet vlera e banimit dhe numrin e përfituesve.

Urim Suka - mua më intereson të dijë çka ka ndodh vitin e kaluar.Ta kemi një raport se cilat familje janë financu dhe sa pare iu kanë pagu secilit sepse dikush mund ta bëjë një kontratë me 350€ dhe komuna i paguan 175€ dhe dikush që është më nevojli i paguhet vetëm 80€ dhe nuk më duket e drejtë dhe dua ta kem një raport për asamble.Nëse nuk gaboju vendimin që e kemi marrë vitin e kaluar ka qenë për 7 dhe ju deklaruar që i kemi ndihmu 10 familje.Ne e mbështesim këtë projektvendim por mos me keqpërdor.

Avni Bytyqi - Jam i sigurt që vitin e kaluar vendimi u marr me i ndihmu 10 familje me 50 % sepse viteve tjera ka qenë me 40%.Këtë vit jemi dakordu me Kryetarin dhe të gjithë,me shku me 12.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Fshatin Rekreativ-Turistik në Delloc”;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime sa i përket këtij vendimi dhe thotë që ministria e ka kthyer në rishqyrtim vetëm pse nuk e kemi pas të bashkangjitur hartën grafike të fshatit turistik Delloc. Meqenëse HZK dhe PZHK ekziston në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor në arkivin e tyre, ata kanë mundur ta verifikojnë saktë që a e përfshin parkun nacional të Maleve të Sharrit Komuna. Pas disa konsultimeve që ka pas drejtori me ministrinë ata kanë kërku që të hiqet numri i parcelave dhe kanë kërku ta dërgojmë vetëm sipërfaqen për fshatin turistik rekreativ si dhe kanë kërkuar që ne ti garantojmë që gjatë hartimit të planit rregullues të hollësishëm nuk përfshihet parku nacional Malet e Sharrit.Tani vendimi për kuvend do vijë me këtë ndryshim ku do të hiqet numri i parcelave dhe do të shtohet një nen i ri që gjatë hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm nuk do të përfshihet zona e veçantë parku kombëtar “Malet e Sharrit” dhe ata na kanë konfirmu që vazhdoni kështu dhe do ta konfirmojmë ligjshmërinë.

Urim Suka - dua ti falemderoj drejtorat që po na përgjigjen në takimet që po i mbajmë dhe dua një kritikë të madhe për drejtorin Visar Kuçi i cili sot nuk është këtu dhe nuk është në shumë takime sidomos kur i ka lëndët e veta dhe ne nuk kemi hapësirë me u sqaru dhe me i marrë vendimet e duhura.Të paktën të jetë prezent kur i ka pikat e veta.

Avni Bytyqi - mua nuk më ka delegu me dhënë arsyetim të tillë por megjithatë kam qenë në komunikim të vazhdueshëm me drejtorin dhe ministrinë. Sipas disa emailave që kemi me ministrinë kanë thënë që është në rregull dhe mund të vazhdojmë.

Kryesuesi - sot nuk është prezent sepse më ka kontakti dhe e di rastin mirëpo materiali i shkon të gjithë drejtorave dhe i dinë datat dhe orët e mbledhjeve.

Sanie Kuçi Rexhepaj - të njëjtën çështje që e ngriti Urimi unë e kam ngrit edhe mbledhjen e kaluar dhe kam thënë që nëse drejtori nuk është, të delegohen zyrtarë në KPF që janë marrë me atë çështje në dhe ta informojë edhe drejtorin për çështjet që janë ngrit dhe me pas parasysht në mbledhje me u përgatit.

Për mendimin tim projektvendimi është shumë më i kompletuar se sa herave tjera që na ka ardhë. Ajo që më pengon dhe që mandatin e kaluar ka qenë dhe tash nuk është, është që drejtorat nuk i kompletojnë lëndët totalisht për asamble dhe nuk e merr asnjëri fjalën me prezantim si pikë dhe ne pastaj ti bëjmë pyetjet tona.

Armend Krasniqi - nuk pajtohem me Sanien ku i përgjithëson të gjithë drejtorat sepse edhe nëse di dhe nëse nuk di, jam mundu me iu përgjigj çdo pyetje dhe çdo hamendësimi që e keni. Çdo pikë që e kamë sponsorizu, kam dhënë qartësime dhe elaborime dhe faktikisht çdo pikë është votu unanimisht.

Sanie Kuçi Rexhepaj - për prezencë të kam lavdu disa herë por prezantimin e pikave gjithmonë e bën kryesuesi .

Kryesuesi - prezenca e drejtorave duhet me qenë çdo herë por faktikisht drejtorat gjithmonë kanë dhënë sqarime kur keni kërku. E hedh në votim pikën 4.

5 për, 2 apstenime, Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Armend Krasniqi - dua ta ngris një çështje në KPF dhe te zyra ligjore e Kryetarit. Vendimet kohëve të fundit të cilat po vonohen, p.sh. dy lokale që i kemi vendos ka dy muaj dhe vendimet janë vonu shumë. Më herët është propozu që me dërgu edhe komisionin dhe parcelën të njëjtën seancë mirëpo tash as seancën e ardhshme nuk po vje dhe po shkojnë 2-3 muaj. Është një dëmtim i komunës që nuk inkason të hyra.

Avni Bytyqi - për pronën që e ka dhënë pëlqimin kuvendi është formuar komisioni dhe vendimin e komisionit e ka marrë drejtori i urbanizmit dhe për dy lokalet që e ka dhënë pëlqimin kuvendi për të zhvillu procedurat e ankandit publik afatshkurt, është formua komisioni në kuvend dhe vendimin komisionit e ka marrë drejtori i urbanizmit.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës 01-Nr-181-30362;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin. Nuk ka debat, e hedh në votim pikën 6.

Unanimisht Miratohet

Takimi përfundoi: 14:00

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj